



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr.04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt.22 Nëntor 2012, nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjilanit, për qëllimin e rregullimit të infrastruktures rrugore, pas Rekomandimit të Komitetit për Pronë dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, për këmbimin e pronës komunale me pronën e Bashkësisë Islame, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me date 24.09.2013, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme të Bashkësisë Islame “Xhamia e Deremahallës”

I.

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën e Bashkësisë Islame “Xhamia e Deremahallës” në Gjilan.**

II.

Lejohet këmbimi i pjesës prej 36 m² i sipërfaqes së ngastrës kadastrale P-70403013-04583-0, nga sipërfaqja e tërsishme prej 313 m², pronar Këshilli i Bashkësisë Islame Gjilan, e cila sipërfaqe në vendin e ngjarjes shfrytëzohet si rrugë publike dhe trotuar në dobi të parcelës P-70403013-04583-2 rrugë komunale. Kurse nga ngastra kadastrale 4791-2 pronë komunale të regjistrohet sipërfaqja prej 51 m² në dobi të ngastrës kadastrale 04583-0 e cila gjindet prapa xhamisë së Deremahallës.

III.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bënë parcelimin e ngastrave të cilat janë objekt i këtij këmbimi dhe të bënë regjistrimin e pronave të këmbyerë në Regjistrat Kadastral.

VI.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

VII.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 16-100738

Gjilan, më 24.09.2013

Kuvendi i Komunës

Izmi ZEKA, Kryesues